



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e kryetarit

02 Nr. _____ /2025 Dt.17/12/2025

U mbajt mbledhja e IV-të e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

PROCESVERBAL

U mbajt mbledhja e katërt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), e cila u udhëhoq nga z. Izet Zenuni, Drejtor për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Në këtë mbledhje morën pjesë shumica e anëtarëve të KKSBB-së, monitorues nga OSBE-ja, si dhe përfaqësues nga KFOR-i.

Pikat e rendit të ditës që u diskutuan ishin:

1. Vlerësimi i gjendjes së sigurisë në Komunën e Deçanit (informatë nga Policia e Kosovës);
2. Marrja e masave për parandalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit;
3. Diskutimi i Draft Planit Vjetor të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026;
4. Të ndryshme.

Në fillim të mbledhjes u miratua rendi i ditës. Në kuadër të pikës së parë, raportoi komandanti i Stacionit Policor në Deçan, toger Xhemë Moriçi, i cili theksoi se, në përgjithësi, gjendja e sigurisë në Komunën e Deçanit është e qetë dhe stabile.

Policia e Kosovës apeloj tek qytetarët për kujdes të shtuar gjatë përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit. Po ashtu, komandanti theksoi se janë ndërmarrë masat e nevojshme për pritjen e bashkatdhetarëve, si dhe për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Në pikën e dytë u diskutua për ndërmarrjen e masave për parandalimin e përdorimit dhe keqpërdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit. Me këtë rast, z. Egzon Qakadiu, përfaqësues i personave me aftësi të kufizuara, kërkoi që të gjitha pikat e shitjes që posedojnë leje, të kenë të shfaqur njoftimin me të cilin ndalohet shitja e mjeteve piroteknike për personat nën moshën 18 vjeçare.

Në pikën e tretë, koordinatorja e KKSBB-së, znj. Gentiana Iberhysaj-Mazrekaj, prezantoi Draft Planin Vjetor të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026, i cili u votua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e KKSBB-së. Ajo kërkoi nga të pranishmit që sugjerimet, komentet apo propozimet për plotësim të dorëzohen përmes postës elektronike deri më datën 15 janar.

Në fund të takimit, të gjithë anëtarët u pajtuan që të dalin me këto konkluzione:

- Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Deçan të rrisë nivelin e gatishmërisë gjatë festave të fund vitit, për pritjen e bashkatdhetarëve, si dhe për mbarrëvajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme;
- Të ndalohet shitja e mjeteve piroteknike për personat nën moshën 18 vjeçare, si dhe të mos lejohet vendosja e tendave dhe shitja e mjeteve piroteknike në dhe përreth qendrës së qytetit të Deçanit.

